



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr. 31, datë 20.4.2018**

**Për**

**“Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Neofone për disa ndryshime dhe shtesa në vendimet Nr.12, Nr.13 dhe Nr.14 –datë 22.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 20.4.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

*“Mbi shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Neofone sh.p.k nr.317 Prot, datë 23.03.2018 (ref .AKEP: nr. 942 prot., datë 27.03.2018) për disa ndryshime dhe shtesa në vendimet Nr.12, Nr.13 dhe Nr.14 –datë 22.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP”*

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**); Neni 130 e vijues
3. Neni 8 i Rregullores së Brendshme “Për Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;

## KËSHILLI DREJTUES

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- i. Ankimi Administrativ i sipërmarrësit Neofone me nr.317 Prot, datë 23.03.2018 (ref .AKEP: nr. 942 prot., datë 27.03.2018) për disa ndryshime dhe shtesa në VKD Nr.12, Nr.13 dhe Nr.14 –datë 22.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP.
- ii. Relacioni shpjegues për shqyrtimin e ankimeve administrative të Neofone (**Relacioni**);
- iii. Projekt Vendimi;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

### V Ë R E N:

#### FAKTI DHE RRETHANAT

Nga shqyrtimi i pretendimeve të sipërmarrësit ankimues Neofone sh.p.k, arsytetimeve dhe akteve të paraqitura në shkresën nr.316 Prot, datë 23.03.2018 si dhe nga analiza e plotë e çështjes objekt shqyrtimi, organi administrativ përpara të cilit drejtohet dhe shqyrtohet çështja sipas shkronjës a) të nenit 134/1 të ligjit nr. 44/2015, është Këshilli Drejtues i AKEP;

Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike Neofone sh.p.k. me anë të shkresës nr.317 Prot, datë 23.03.2018 (ref .AKEP: nr. 942 prot., datë 27.03.2018) me objekt “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKD nr.12, datë 22.02.2018 “Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik të lëvizshëm Vodafone Albania dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT”, VKD nr.13 datë 22.02.2018 “Përcaktimin e sipërmarrësit Telekom Albania sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik të lëvizshëm Telekom Albania dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT” dhe VKD nr.14 datë 22.02.2018 “Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik të lëvizshëm Altelecom dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT”

Përmes këtij ankimi sipërmarrësi Neofone kërkon nga AKEP ndërmarrjen e disa ndryshimeve në vendimet e lartpërmendura për të krijuar një konkurrencë efektive në tregun e komunikimeve elektronike, duke mos qënë dakort me përcaktimet që janë bërë në seksionin IV-Analiza për FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare, nënseksioni-Terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

Sipas ankimit administrativ, Neofone nuk është dakord me përkufizimin e tregut përkatës që është dhënë në dokumentin përfundimtar të analizës tregut dhe statusi me FNT është vetëm për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare dhe fikse kombëtare. Kjo pasi sipas Neofone “*metodologjia e AKEP për të trajtuar në dy mënyra të ndryshme edhe si dy tregje të ndryshme tregun e terminimit të thirrjeve kombëtare edhe tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare shkel principin e mos-diskriminimit sipas*

*Direktivave të BE të cilat përcaktojnë qartë se nuk lejohet të diskriminohet trafiku nga origjina dhe se rekomandimet e Komisionit Europian kanë përcaktuar vetëm një treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet publike të lëvizshme”.*

Neofone thekson se në tregun e terminimit të thirrjeve kombëtare e ndërkombëtare nuk ka konkurrencë efektive, nisur nga fakti se të tre operatorët Vodafone Albania, Telekom Albania edhe Albtelecom, kanë 100 % të pjesëve të tregut duke monopolizuar shërbimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet, që nënkupton barriera të larta hyrëse që nuk i lejon operatorët e tjerë të ofrojnë shërbime konkurruese në terma afat shkurtër, edhe që nuk ekzistojnë operatorë të cilët mund të ushtrojnë fuqi kundërvepruese të mjaftueshme për të kufizuar aftësinë e operatorëve mobile për të ofruar shërbimin e terminimit të thirrjeve në nivel shumice në mënyrë të pavaruar nga konkurentët, klientët edhe konsumatorët.

Si përfundim, objekti i Ankimit Administrativ është ndryshimi i Vendimit Nr.12, Nr.13 dhe Nr.14 datë 22.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, si më poshtë: ***Përkufizimi i tregut përkatës është për terminimin e të gjitha thirrjeve si ato kombëtare edhe ato ndërkombëtare pa diskriminuar nga origjina.***

## **QËNDRIMI I AKEP**

AKEP në dokumentin “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokumenti Përfundimtar*”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 2118, datë 4.07.2012, e ka trajtuar në një seksion të veçantë terminimit të thirrjeve ndërkombëtare hyrëse.

AKEP, bazuar edhe në komentet e operatorëve si dhe në informacionin nga vendet e rajonit në raportin e Mars 2012 të Cullen International<sup>1</sup>, evidentohet që terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të mos jetë pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve hyrëse në një rrjet celular, pra që shërbimi ku operatori është me FNT të përfshijë vetëm terminimin e thirrjeve kombëtare, dhe se dhënia e aksesit dhe tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në një rrjet celular është objekt i negociatave komerciale midis paleve, ku në të gjitha vendet e rajonit tarifat e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare përcaktohen në marrëveshje konfidenciale dhe janë jashtë rregullimit.

Edhe në dokumentin e analizës së tregut të vitit 2014, miratuar me VKD nr.2522, datë 6.11.2014, AKEP ka sqaruar se në vijim të përfundimeve të Analizës së tregut 2012, tregu përkatës i terminimit përfshin vetëm terminimin e thirrjeve kombëtare. Në Analizën e tregut celular, të miratuar me VKD nr. 2118, datë 4.07.2012, AKEP ka përfshirë një seksion të veçantë (Seksioni III.3.III) për diskutimin në lidhje me detyrimet për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke përfshirë dhe kronologjinë e derregullimit të këtij shërbimi. Në këtë dokument AKEP përcaktoi që terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në një rrjet celular nuk është pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet celular, pra statusi me FNT dhe gjithë detyrimet e tjera për FNT për terminimin e thirrjeve janë të zbatueshme vetëm për terminimin e thirrjeve hyrëse kombëtare.

Duhet theksuar se AKEP arrit në këtë përfundim pas procesit të këshillimit publik të analizës së tregut, ku dhe Neofone ka qenë pjesëmarrës në proces me komente, dhe ndër argumentat pro de-rregullimit ishte dhe fakti se terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është input për tregjet me pakicë në vendet e huaja dhe jo në Shqipëri, pra që nuk kanë ndikim në tregun

---

<sup>1</sup> As for calls originated from abroad, termination rates are not regulated in most countries (Croatia, Montenegro, Albania, Macedonia, Turkey Serbia and Kosovo), and are defined by commercial agreement (confidential).

vendas. AKEP gjykoi ndër të tjera se alternativa e duhur për derregullimin ishte alternativa 'c' e pyetjes 5 të këshillimit publik:

*Detyrimet e operatorëve me FNT për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare duhet të de-rregullohen plotësisht: operatorët celularë të mos kenë detyrim të japin akses, pra dhënia e aksesit dhe tarifa të jenë komerciale kur kanë interes të dy palët.*

Në bazë të këtij përfundimi, AKEP në vendimet përkatëse për shpalljen me FNT të operatorëve celularë, ka hequr detyrimet e operatorëve celularë për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

Duke i'u referuar precedentit vlen të vihet në dukje se pas de-rregullimit të tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare AKEP ka trajtuar disa raste të ngjashme ankimi, për të cilat janë marrë vendimet përkatëse dhe mund të gjendet të publikuara në faqen ëeb të AKEP.

Një faktor tjetër në favor të de-rregullimit të tarifës dhe të aksesit për thirrjet hyrëse ndërkombëtare është trajtimi nga Komisioni Evropian (KE) i roamingut ndërkombëtar. KE bazuar në problemet e tarifave të larta të roamingut për thirrjet dhe të dhënat për përdoruesit, ka vendosur nën-rregullim tarifat e roamingut ndërkombëtar (me pakicë dhe me shumicë) në vendet e BE, duke imponuar tarifa maksimale (çmime tavan) për operatorët në vendet e BE, por vetëm në marrëdhëniet midis operatoreve të vendeve të BE: tarifat e roamingut që operatorët e vendeve të BE i paguajnë njëri-tjetrit janë nën - rregullim<sup>2</sup> por tarifat që paguajnë operatorët jashtë vendeve të BE operatorëve të vendeve të BE për roaming ndërkombëtar nuk janë nën-rregullim. Pra, vetë KE ka bërë një ndarje midis vendeve të BE dhe jo të BE, pasi masat e marra kanë impakt për përdoruesit në vendet e BE.

Gjithësesi, lidhur me këtë ankim administrativ të sipërmarrësit Neofone, AKEP sqaron se terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është analizuar në dokumentin “*Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimi: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare*” miratuar për këshillim publik me VKD nr.16, datë 22.02.2018 ku janë marrë në konsideratë përveç të tjerave edhe rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës, si dhe rekomandimet e BE e BEREC dhe procedura e konsultimit publik përfundon me datë 28.4.2018.

## **A T Ë H E R E:**

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar në Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 114, neni 115, si dhe Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” (**Ligji nr. 44/2015**) neni 130 e në vijim,

## **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e ankimit administrativ të Neofone Shpk me nr.317 Prot, datë 23.03.2018 (ref .AKEP: nr. 942 prot., datë 27.03.2018) për disa ndryshime dhe shtesa në VKD Nr.12, Nr.13 dhe Nr.14 – Datë datë 22.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP.

---

<sup>2</sup>Psh: operatori Vodafone UK nuk mund të tarifojë operatorin T-Mobile në Gjermani me shumë se tarifa e përcaktuar nga komisioni, në rastin kur një përdorues i T-Mobile përdor rrjetin Vodafone UK gjatë qëndrimit në këtë vend),

2. Lënien në fuqi të Vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.12, Nr.13 dhe Nr.14 – Datë datë 22.02.2018.
3. Të njoftohet sipërmarrësi Neofone sh.p.k. për këtë Vendim.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**KRYETARI**

**Ilir ZELA**

**ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Anila DENAJ
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI